



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA



Prishtinë, 02.08.2021

Vendimet e Bordit të FBK-së të datës 02.08.2021, Prishtinë

Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) në mbledhjen e mbajtur më 02.08.2021 në Prishtinë ka shqyrtuar situatën aktuale në basketbollin kosovar dhe, ndër të tjera, ka vendosur si në vijim:

1. I ka miratuar propozim-ndryshimet në Rregulloren për Licencim dhe Garim të klubeve për edicionin 2021/22 dhe e ka miratuar procedurën për Thirrjen për Aplikim për Plotësim të Kriteve për Licencim të Klubeve të Superligës së Meshkujve për edicionin 2021/22.
2. I ka miratuar propozim-ndryshimet në Rregulloren për Kalim dhe Regjistrim për edicionin 2021/22.
3. Ka vendosur që Superkupa e Kosovës në konkurrencën e meshkujve të zhvillohet prej 1 deri më 5 Shtator 2021.
4. Ka vendosur që edicioni i ri i garave në Prince Caffè Superligë të fillojë më 8/9 Shtator.
5. Ka vendosur që afati kalimtar për Superligën e Femrave për lojtare vendore të jetë i hapur deri më 27 Gusht në ora 16:00.
6. E ka shqyrtuar pozitivisht kërkesën e KB Vëllaznimi për hapje të Wild Card për pozitën e nëntë (9) në Superligë dhe në ditët në vazhdim do të bëjë të ditur procedurën dhe kriteret për aplikim për Wild Card.
7. I ka shqyrtuar kërkesat e KB Sigal Prishtina dhe KB Peja për garim në edicionin 2021/22 në Ligën Ballkanike dhe ka vendosur që klubet në fjalë së pari duhet të plotësojnë kriteret për licencim në FBK konform Thirrjes, e cila do të hapet më 6 Gusht, duke përfshirë këtu kryerjen e obligimeve ndaj FBK-së dhe FIBA-s.
8. E ka vazhduar mandatin edhe për një vit të Komesarit të Garave në Federatën e Basketbollit të Kosovës, konform Statutit të FBK-së.
9. E ka miratuar Raportin e Punës të Kampit Nacional të FBK-së.

Federata e Basketbollit të Kosovës

+383 48 703 333
federata@basketbolli.com

Lagja "Arbëria", Blloku
C3 (Faza 2), Rr. Radovan
Zogoviq, Hyrja 7
10000 Prishtinë, Kosovë



Vendimet hyjnë në fuqi në ditën e miratimit të tyre.



RUGOVE GROWZILLAS

Në emër të Bordit të FBK-së,

Arben FETAHU
Kryetar



Federata e Basketbollit të Kosovës